



Universiteti POLIS

Nr. 66/26 Prot.

Data 26/01/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN

Nr. 51/4 Prot.

Tiranë, më 22.01.2026

Lënda: Përcillen vendimet e Bordit të Akreditimit

UNIVERSITETIT POLIS

Rruga Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar Kodi Postar 1051, Kutia
Postare 2995,


TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të radhës, të mbajtur më datë 13 Dhjetor 2025, mori vendime që lidhen me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të disa programeve të studimit.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimet e Bordit të Akreditimit Nr. 197 dhe 198, datë 13.12.2025.

Gjithashtu ju bëjmë me dije se vendimet janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM


Anisa Subashi



Adresa: Blloku i Ambasadave, Rr.Skënderbeg, Pallati nr.8, Shkalla 1, Tiranë;

Tel: +355(0)2243423/2266203;

web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

Faqe 1 nga 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 198, datë 13.12.2025

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER I SHKENCAVE NË “MENAXHIM MJEDISOR URBAN”, TË
UNIVERSITETIT “POLIS”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824, datë 24.12.2021, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 224, datë 15.12.2023 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 13.12.2025, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “**Menaxhim Mjedisor Urban**”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Master i Shkencave në “**Menaxhim Mjedisor Urban**”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 406, datë 26.05.2010
- d) Akreditimi periodik: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 06, datë 01.02.2019
- e) Institucioni që e ofron: Universiteti “Polis”
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Mjedisit
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 2 vite / 4 semestra
- h) Kredite (ECTS): 120 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Gjuha e mësimdhënies: Shqip
- k) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti “Polis”
- l) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga akreditimi periodik;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit periodik të këtij programi ka qënë pozitiv, me rekomandim;
- f. Institucioni ka përmbushur rekomandimin e lënë nga akreditimi periodik;
- g. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësi si më poshtë:
 1. Kualifikimi i disa prej anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, nuk është në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
 2. Mungesa e përpjekjeve të mjaftueshme për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi këtë program studimi dhe për promovimin e tij si një rrugë karriere e qëndrueshme dhe e orientuar drejt së ardhmes.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:


1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Master i Shkencave në **“Menaxhim Mjedisor Urban”**, të Universitetit **“Polis”**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **5 (pesë) vite**.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **12.12.2030**.

4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ



Kryetare

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

IRAJ HASHI



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

DARINKA PIQANI



Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

MIRJETA BEQIRI



Anëtar

NIKOLLA QAFOKU



Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ



Anëtar

LORETA KONDILI

Loreta Kondili

Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 198, datë 13.12.2025, “Për akreditimin periodik të programit të studimit Master i Shkencave në **“Menaxhim Mjedisor Urban”**, të **Universitetit “Polis”**, janë si vijon:

1. Institucioni, të marrë masa që kualifikimi i anëtarëve të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, të jetë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
2. Institucioni, të ndërmarrë fushata të synuara informimi dhe aktivitete sensibilizuese për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e menaxhimit mjedisor, si dhe mbi mundësitë dhe sfidat e këtij profesioni, me qëllim rritjen e interesit për programin e studimit dhe përmirësimin e punësimit të të diplomuarve.
3. Institucioni, të rrisë më tej nivelin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të zgjerojë pjesëmarrjen në programet ndërkombëtare, në drejtim të mobilitetit të personelit akademik dhe veçanërisht të studentëve, të këtij programi studimi.
4. Institucioni, të forcojë bashkëpunimin me institucione publike dhe private për të përmirësuar perspektivat e punësimit të studentëve të këtij programi studimi.
5. Institucioni, të integrojë në mënyrë më të qartë sfidat e urbanizimit dhe ndryshimet demografike në kurrikulën e këtij programi studimi, duke siguruar përgatitje të thelluar për menaxhimin e qyteteve dhe zonave urbane.
6. Institucioni, të zbatojë mekanizma të avancuara për monitorimin dhe vlerësimin sistematik të cilësisë së programit të studimit.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Universiteti “Polis”**, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 2 (dy) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

